



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr.

Prot.

Date 19.11.2009

V E N D I M

Nr. 129 Datë 19.11.2009

“Për

**hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e produktit lëndë
djegëse Diesel D2 për ndërmarrjen “ARMO” SHA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|-----------|-------------|---------|
| • Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • Servete | GRUDA | Anëtar |
| • Koço | BROKA | Anëtar |
| • Rezana | KONOMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 19.11.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Shqyrtimi i Raportit të Hetimit Paraprak “Mbi sjelljen e ndërmarrjes “ARMO”SHA në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë e pakicë të produktit lëndë djegëse për automjete Gazoil (D2)”

Baza ligjore:

- Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të Hetimit Paraprak “Mbi sjelljen e ndërmarrjes “ARMO”SHA në tregun e tregtimit me shumicë e pakicë të produktit lëndë djegëse për automjete Gazoil (D2)” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.

VËREN SE :

1. Nga Hetimi Paraprak mbi sjelljen e ndërmarrjes “ARMO” ShA në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë e pakicë të produktit lëndë djegëse për automjete Gazoil (Diesel) D2, rezultoi se: Ndërmarrja ARMO Sh.A zotëron 80.75% të tregut përkatës të produktit Diezel D2 për periudhën objekt - hetimi në vitin 2009. Në bazë të nenit 8, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe duke patur parasysh edhe udhëzuesin e Komisionit Evropian¹, “Mbi zbatimin e nenit 82 të Traktatit”, ndërmarrja ARMO Sh.A zotëron pozitë dominuese në tregun e prodhimit dhe tregtimit të produktit përkatës, lëndë djegëse Diesel D2.
2. Ndërmarrja “ARMO” sh.a është e integruar vertikalisht në tregun e tregtimit me shumicë dhe në tregun e tregtimit me pakicë të karburanteve, pasi njëri prej aksionarëve të saj, zotëron 100% të aksioneve të ndërmarrjes “ANIKA” sh.a, e cila zotëron 70% të aksioneve të konsorcium “AMRA” sh.a, e cila nga ana e saj zotëron 85 % të aksioneve të ndërmarrjes ARMO Sh.A. Pra aksionari, i cili zotëron 100% të aksioneve në ndërmarrjen e tregtimit me shumicë “TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING AND SUPPLY COMPANY” SHA dhe në ndërmarrjen e tregtimit me pakicë “KUID” sh.p.k, në mënyrë indirekte zotëron 68% të aksioneve në ndërmarrjen “ARMO” Sh.a.
3. Nga kontrolli i faturave të shitjes së ndërmarrjes ARMO sha, rezulton se kjo ndërmarrje shet me çmime të ndryshme në të njëjtën ditë ndaj kompanive të shitjes me shumicë, veprim i cili mund t'i vendosë ato në gjendje të pafavorshme konkurrence dhe mund të bjerë në kundërshtim me nenin 9, pikat 1 dhe 2, (germa c), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Kjo sjellje e ndërmarrjes ARMO Sha konstatohet gjatë gjithë periudhës së marrë nën hetim.
4. ARMO sh.a gjatë periudhës hetimore ka shitur në mënyrë të drejtë për drejtë edhe në nivelin e “Rrjedhës së poshtme” të tregut (shitje me pakicë). Shitja e Dieselit (D2) nga ana e ndërmarrjes ARMO SHA në tregun me pakicë (stacionet) është e ndaluar nga Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”. Në këtë ligj përcaktohet se shitja e Dieselit D2 nga rafineritë mund të realizohet vetëm në kompanitë që kanë leje tregtimi të kategorisë A (kompanitë që shesin në “Rrjedhën e sipërme”, shumica).
5. Tregtimi i produktit lende djegese Diezel(D2) ne te njejten kohe e ndermarrjes ARMO sha, si ne tregun e shumices dhe ne tregun e pakices

¹ Eksperienca e komisionit sugjeron që dominanca në tregut përkatës zotërohet nëse pjesa e tregut përkatës e ndërmarrjes është të paktën 40%.

i ka krijuar asaj nje avantazh te dukshem konkurrues pasi duke qene operator kryesor ne tregun e shitjes me shumice te diezelit kjo ndermarrje ka patur ekskluzivitet per te vendosur cmimet ne nivel tregtimi me shumice, duke vendosur ne pozita te pafavorshme ndermarrjet e tjera te licensuara per tregtimin me shumice te karburanteve.

6. Këto sjellje, në zbatim të nenit 9, pikat 1 dhe 2 , të Ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 dhe nenin 21, pika 4, te Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit te Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj ndërmarrjes: **“ARMO” SHA**; me objekt ekzistencën ose jo te abuzimit me pozitën dominuese në tregun përkatës të produktit lëndë djegëse Diesel D2;
- II. Hetimi i Thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2009 deri në 31.10.2009.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)
Anëtar

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Rezana Konomi

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETAR